



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 186

Tiranë – E enjte, 22 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 38, datë 19.10.2020	Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues, të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, si dhe ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore..... 12677
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 385, datë 13.10.2020	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”..... 12677
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 424, datë 16.10.2020	Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara..... 12687
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 425, datë 16.10.2020	Për përcaktimin e formatit të aplikimit dhe kundërshtimit të produkteve bujqësore ose ushqimore si specialitet tradicional i garantuar..... 12689
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6395/6, datë 19.10.2020	Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë..... 12697

**UDHËZIM****Nr. 38, datë 19.10.2020**

**PËR FALJEN E MASAVE
ADMINISTRATIVE ME KARAKTER
NDËSHKUES, TË VENDOSURA GJATË
PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË
SHKAKTUAR NGA COVID-19, SI DHE
NDAJ FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA
FATKEQËSITË NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4, të nenit 2, të aktit normativ nr. 31, datë 7.10.2020 “Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore”,

UDHËZOJ:

1. Kthimi i shumës së detyrimit të falur, por të paguar për masat administrative me gjobë, merret nga llogaria ekonomike në të cilën është arkëtuar në sistemin informatik financiar të qeverisë (arkëtim i konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë dhe struktura përgjegjëse e institucionit përkatës në emër të së cilit është paguar gjoba).

2. Përfituesit (individë dhe subjekte) duhet të dërgojnë pranë strukturës përgjegjëse të institucionit që ka vendosur masën administrative në favor të të cilit është bërë pagesa e gjobës (shkurt institucioni) informacionin lidhur, me:

- a) emër mbiemër i individit/emërtim i subjektit;
- b) ID kartë identiteti/NIPT;
- c) IBAN;

d) emrin e bankës pranë së cilës kanë llogarinë personale/llogarinë e subjektit;

e) vërtetimin bankar që llogaria bankare ku do të arkëtohet kthimi i gjobës është aktive;

f) subjektet paraqesin edhe vërtetimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

3. Struktura përgjegjëse e institucionit harton urdhërpagesën për vlerat totale për çdo bankë të nivelit të dytë ku është kryer arkëtimi i gjobës, duke i bashkëlidhur listën emërore të përfituesve për bankën respektive. Urdhërpagesa për kthimin e gjobave subjekteve shoqërohet me vërtetimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe vërtetimin bankar.

4. Pas konfirmimit nga struktura përgjegjëse për Thesarin në degë, struktura përgjegjëse të institucionit dërgojnë paralelisht listën emërore të individëve përfitues në bankën respektive të nivelit të dytë.

5. Institucionet me vetëfinancim që operojnë me llogari bankare të veçantë nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e qeverisë”, në Bankën e Shqipërisë, zbatojnë procedurat e tyre të miratuara nga titullari.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen struktura përgjegjëse të institucionit dhe struktura përgjegjëse për Thesarin në degë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM**Nr. 385, datë 13.10.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR MARRJEN E
LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË
AUTORIT, RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI
DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR
PEZULLIMIN DHE HEQJEN E
LICENCËS NË ZBATIM TË LIGJIT NR.
35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË
DREJTAT E AUTORIT DHE TË
DREJTAT E TJERA TË LIDHURA
ME TO”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe neneve 158 dhe 188, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

UDHËZOJ:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****A. Qëllimi i udhëzimit**

Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për marrjen dhe/ose ripërtëritjen e licencës nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv (këtej e tutje “AAK”), në zbatim të neneve 133, 134, 135 dhe



159, të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, si dhe kriteret dhe procedurat për rastet e tjera që përbëjnë kusht për pezullimin apo heqjen e licencës së AAK-së.

B. Kriteret për marrjen e licencës si AAK

1. Për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, organizata jofitimprurëse, përveç sa parashikuar në nenet 133, 134 dhe 135, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duhet të ketë edhe:

a) disponon një listë të mbajtësve të të drejtave, që kanë dhënë pëlqimin me shkrim për ta autorizuar për administrimin e të drejtave të tyre;

b) dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja, në gjuhën shqipe;

c) ka kushte të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer funksionet e saj;

ç) ka ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

d) ka ekspertizë profesionale me një punonjës jurist të dokumentuar me dokument punësimi dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

dh) ka ekspertizë profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

e) deklaron se gëzon mekanizma të mjaftueshëm lidhur me monitorimin, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve, në mënyrë të drejtë dhe transparente, bazuar në përdorimin e veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit dhe objekteve të tjera të lidhura me to;

ë) paraqet deklaratë për plotësim të kriterëve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të germës B, jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

f) dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “a” dhe “b”, të kësaj pike, do të shoqërohet me lista të plota të titujve të veprave të cilat do të administrohen, jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj pas

marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;

g) depoziton pagesën e tarifës për aplikim për licencimin të organizatës si AAK, në përputhje me pikën 4, të nenit 157, të ligjit nr. 35/2016 dhe vendimit nr. 33, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

C. Kriteret për ripërtëritjen e licencës së AAK-ve

1. Për ripërtëritjen e licencës, për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, AAK-ja, përveç sa parashikuar në nenet 133, 134, 135, 137, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duhet të ketë edhe:

a) disponon kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre, sipas ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

b) disponon kontratat për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja, në gjuhën shqipe;

c) garanton mënyrën efektive të funksionimit të brendshëm dhe respektimit të akteve rregulluese;

ç) ka kushte të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer funksionet e saj;

d) ka ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

dh) ka ekspertizë profesionale me një punonjës jurist të vërtetuar me kontratë punësimi. Punonjësi është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

e) ka ekspertizë profesionale me një punonjës në fushën financiare të vërtetuar me kontratë punësimi. Punonjësi është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse;

ë) dëshmon se ka kryer monitorimin, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve në mënyrë të drejtë dhe transparente, bazuar në përdorimin e veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;

f) depoziton pagesën e tarifës për aplikim për ripërtëritjen e licencës të organizatave si AAK, në



përputhje me nenin 157, të ligjit nr. 35/2016 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”;

g) depoziton raportin dhe bilancin vjetor për performancën e saj në lidhje me mbledhjen, shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e tyre dhe shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

D. Procedura për aplikim për licencë apo ripërtëritje të saj

1. Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, ngre grupin e punës për fillimin e procedurave për licencimin apo ripërtëritjen e licencës së AAK-ve dhe përcaktimin e afateve për shqyrtimin e dokumentacionit.

2. Nëpërmjet një thirrje publike në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, njoftohen të gjitha subjektet që mund të kenë interes për pajisjen me licencë apo ripërtëritje të saj për kategorinë përkatëse për të drejtat e autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to.

3. Subjektet e interesuara dhe AAK-të duhet të paraqesin kërkesën për licencim apo ripërtëritje të licencës për Agjencinë e Administrimit Kolektiv, e cila përmban:

- a) kërkesë për shprehje interesi;
- b) formularin e aplikimit sipas formatit të miratuar bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- c) dokumentacionin shoqërues, i cili vërteton përmbushjen e të gjitha kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 35/2016 dhe në shkronjat B dhe C, të kreut I, të këtij udhëzimi;

4. Afati për depozitimin e kërkesave dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim ose ripërtëritjen e saj është 30 ditë kalendarike nga data e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

5. Dokumentacioni depozitohet pranë protokollit të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.

6. Brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit, kryhet shqyrtimin e dokumentacionit dhe i paraqitet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit propozimet sipas parashikimit të shkronjës “ë”, pika 2, e nenit 157, të ligjit nr. 35/2016.

7. Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit vendos me urdhër për licencim ose ripërtëritje të licencës së AAK-së.

8. Urdhri i ministrit për licencim apo ripërtëritje të licencës hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

II. PEZULLIMI OSE HEQJA E LICENCËS SË AAK-së

A. Kushtet dhe procedura për pezullimin e licencës së AAK-së

1. Pezullimi i licencës së një AAK-je bëhet në rastet e mëposhtme:

a) moszbatimi i pikave 1 dhe 2, të nenit 153, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

b) mosdhënia e informacionit të kërkuar te ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit brenda 10 ditëve pune, në bazë të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 157, të ligjit nr. 35/2016;

c) moszbatimi i detyrimit të shkronjës “ë”, pika 1 e germës B, të këtij udhëzimi;

2. Procedura e pezullimit të licencës së një AAK-je:

a) në rast se Drejtoria për të Drejtën e Autorit (në vijim “DDA”), kryesisht ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, konstaton shkeljet e parashikuara në pikën 1, të këtij kreu, referuar pikës 5, të nenit 159, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, njofton ministrin përgjegjës për të drejtën e autorit;

b) DDA-ja urdhëron AAK-në për rregullimin e të metave të konstatuara brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;

c) brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, AAK-ja vë në dijeni DDA-në për rregullimin e të metave dhe paraqet dokumentacionin provues për masat e marra;

ç) në rastet e mos rregullimit të të metave brenda afatit të parashikuar në shkronjën “b”, pika 2, të germës A, të këtij kreu, DDA-ja menjëherë i propozon ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit fillimin e procedurës për pezullim licence;

d) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit ngre menjëherë grupin e punës për zhvillimin e procedurës administrative;

dh) grupi i punës zhvillon dhe përfundon procedurën administrative sipas përcaktimeve të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;



e) DDA-ja bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit fillimin e procedurave për pezullimin për 6 (gjashtë) muaj të licencës;

ë) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, bazuar në raportin e DDA-së, urdhëron për pezullim ose jo të licencës së AAK-së;

f) AAK-së ndaj së cilës është marrë masa e pezullimit të licencës humbet të drejtën të ushtrijë funksionet për të cilat është licencuar për periudhën e pezullimit;

g) urdhri i ministrit për pezullimin e licencës hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

B. Kushtet dhe procedura për heqjen e licencës së AAK-së

1. Heqja e licencës së një AAK-je bëhet në rastet e mëposhtme:

a) kur konstatohen shkelje të kuadrit ligjor për të drejtën e autorit lidhur me shpenzimet dhe shpërndarjet e shpërblimeve;

b) kur AAK-ja përfaqëson titullarët e të drejtave të autorit për kategorinë për të cilën nuk është licencuar;

c) kur AAK-ja nuk ka bërë deklarin e të gjitha fakteve materiale të mbajtura të fshehura apo të reja, të cilat mund të përbënin shkak për refuzimin e marrjes së licencës pas aplikimit;

ç) kur shkelen parashikimet ligjore të pikës 4, të nenit 133, të ligjit nr. 35/2016.

2. Procedura për heqjen e licencës së një AAK-je është si më poshtë:

a) në rast se DDA-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, konstaton shkeljet e parashikuara në shkronjën B, pika 1, të këtij kreu, referuar pikës 5, të nenit 159, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, njofton menjëherë ministrin përgjegjës për të drejtën e autorit;

b) DDA-ja urdhëron AAK-në për rregullimin e të metave të konstatuara brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;

c) brenda 30 ditëve AAK-ja vë në dijeni DDA-në për rregullimin e të metave dhe paraqet dokumentacionin provues për masat e marra;

ç) në rastet e mos rregullimit të të metave brenda afatit në shkronjës “b”, pika 2, të germës B, të këtij kreu, DDA-ja menjëherë i propozon ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit fillimin e procedurës për heqjen e licencës;

d) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit ngre menjëherë grupin e punës për zhvillimin e procedurës administrative;

dh) grupi i punës zhvillon dhe përfundon procedurën administrative sipas përcaktimeve të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;

e) DDA-ja bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit fillimin e procedurave për heqjen e licencës;

ë) ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, bazuar në raportin e DDA-së urdhëron për heqjen ose jo të licencës së AAK-së;

f) AAK-së ndaj së cilës është marrë masa e heqjes së licencës humbet të drejtën të ushtrijë funksionet për të cilat është licencuar;

g) AAK-ja, ndaj së cilës është marrë masa për heqjen e licencës, humbet të drejtën për aplikim për pajisje me licencë për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare) nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit të ministrit;

gj) urdhri i ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

III. DISPOZITAT KALIMTARE

1. Në rast moslicencimi apo ripërtëritje të licencës, kërkuksi ka të drejtën e ankimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

2. AAK-së së cilës i është pezulluar apo hequr e drejta për të ushtruar veprimtari të administrimit kolektiv, ka të drejtën e ankimit. Ankimi në gjykatë nuk pezullon aktin administrative, përveç kur vendoset ndryshe nga gjykata kompetente.

3. Udhëzimi nr. 5166, datë 20.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ministrit të Kulturës shfuqizohet.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

**Formular Aplikimi për Licencimin e Agjencive të Administrimit Kolektiv për të Drejtën e
Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to**

Data e aplikimit _____
data, muaji, viti

Data e dorëzimit _____
data, muaji, viti

1. Emri, _____
(organizatë pa qëllim fitimi Nenet 133, 134 i ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit
dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe udhëzimit të Ministrit të Kulturës Nr.,
_____ datë _____);

Adresa e selisë së Agjencisë:

- a. Qyteti _____,
b. Rruga _____,
c. Tel: _____,
d. Fax: _____
e. E-mail: _____

2. Përfaqësuesi ligjor i agjencisë, Z/Zj _____.

3. Kategoria e të drejtave të autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to, ku kërkoni të
administroni në emër të mbajtësit të të drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to
(përshkrimi i kategorisë përkatëse);

- a. _____
b. _____
c. _____

4. Vendim regjistrimi në gjykatë, i dalë nga sekretaria gjyqësore:

- a. Nr. _____, Datë _____

5. Statut (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të regjistrimit të
gjykatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera



- të lidhura me to” dhe udhëzimit të Ministrit të Kulturës Nr. _____, datë _____; (objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që agjencia përfaqëson kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese etj.)
6. Ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjinale;
 7. Mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë;
 8. Banka/t dhe Nr. Llogarisë/ve përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare;
 9. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë shtetas shqiptar apo rezident në Republikën e Shqipërisë;
 10. Rregullore e brendshme e dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të mësipërm të regjistrimit në gjykatë.
 11. Administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës;
 12. Listë të mbajtësve të të drejtave që kanë dhënë pëlqimin me shkrim për ta autorizuar për administrimin e të drejtave të tyre;
 13. Dokumentacionin e nevojshëm, në gjuhën shqipe, që dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja;
 14. Dokument provues të kushteve të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj;
 15. Dokument provues të ekspertizës dhe shërbimit teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 16. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës jurist dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse;
 17. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse;



18. Dokument provues për mekanizma të mjaftueshëm lidhur me mbledhjen shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve;
19. Për pikat 13 deri në 17 të këtij formulari depozitohet deklaratë për plotësim të tyre jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to;
20. PAGESA E TARIFËS PËR APLIKIM PËR LICENCIMIN TË ORGANIZATAVE SI AGJENCI TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV, NË PËRPUTHJE ME VENDMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 33, DATË 18.01.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria epër të Drejtën e Autorit”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

**Formular Aplikimi për Ripërtëritjen e Agjencive të Administrimit Kolektiv për të Drejtën
e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.**

Data e aplikimit _____
data, muaji, viti

Data e dorëzimit _____
data, muaji, viti

1. Emri i Agjencisë, _____
(organizatë pa qëllim fitimi Nenet 133, 134 i ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe udhëzimit të Ministrit të Kulturës Nr. _____, datë _____);

Adresa e selisë të Agjencisë:

Qyteti: _____,
Rruga: _____,
Tel: _____,
Fax: _____,
E-mail _____,

2. Përfaqësuesi ligjor i agjencisë, Z/Zj _____;
3. Vendim regjistrimi në gjykatë, i dalë nga sekretaria gjyqësore:
Nr. _____, Datë _____ (i rifreskuar):
4. Ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale;
5. Statut (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të regjistrimit të gjykatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, dhe udhëzimit të Ministrit të Kulturës Nr. _____, datë _____; (objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që agjencia përfaqëson, kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese etj.);
6. Kategoria e të drejtave të autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to që kërkon të administroni në emër të mbajtësit të të drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrimi i kategorisë përkatëse);
- a) _____
b) _____
c) _____



7. Mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë;
8. Banka/t dhe Nr. Llogarisë/ve përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare;
9. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë shtetas shqiptar apo rezident në Republikën e Shqipërisë;
10. Rregullore e brendshme e agjencisë (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të mësipërm të regjistrimit në gjykatë.
11. Kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre.
12. Kontrata për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja në gjuhën shqipe;
13. Administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës;

Po _____ Jo _____
14. Mënyrën e funksionimit të brendshëm dhe respektimit të akteve rregulluese.
15. Raportimin dhe përmbushjen e detyrave nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.
16. Dokumente provues për respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi.
17. Dokumente provues Përmbushjen/zbatimin e parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit për ushtrimin e administrimit kolektiv dhe të legjislacionit në fuqi.
18. Dokumente provues të funksionimit të mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve kundrejt anëtarëve titullarë të të drejtave.
19. Kushte të përshtatshme me pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj;

Po _____ Jo _____
20. Ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
21. Ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse;
22. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse;



23. Dokumentacion, dëshmi për punonjësit që do të jetë pjesë administrative e AAK-së, që vërteton kualifikimet e tyre profesionale, përvojën profesionale dhe njohuritë e gjuhëve të huaja;
24. Deklarimin lidhur me gjendjen gjyqësore të drejtorit ekzekutiv si dhe çdo punonjësi të punësuar;
25. Njësitë përbërëse të administratës së agjencisë, kontratat e punës dhe niveli i pagave të tyre;
26. Deklaratë e gjendjes financiare aktuale të nënshkruar nga Drejtuesi i Agjencisë;
27. Pasuritë e paluajtshme në emër të agjencisë, të vërtetuar me certifikatë pronësie nga ZRPP (kopje e noterizuar).
28. Performancën në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e saj;
29. Performancën në lidhje me shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës;
30. Transparencën e bilanceve, informacionit dhe raportimit me organet e tjera shtetërore;
31. Pagesa e tarifës për aplikim për ripërtëritjen e licencës të organizatave si Agjenci të Administrimit Kolektiv, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.01.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.
32. Procese gjyqësore me objekt cënimi të së drejtave të mbrojtura nga agjencia;
- Po _____ Jo _____
33. Nëse keni listoni dhe paraqisni bashkëlidhur kopje të vendimeve të gjykatës nga sekretaria gjyqësore:
- _____
- _____
34. Certifikatë ose Vërtetime të anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Nëse keni listoni dhe paraqitni bashkëlidhur, kopje të noterizuara të tyre.
- _____

Për Agjencinë e Administrimi Kolektiv

Emri, mbiemër, firmë, vulë, përfaqësuesit ligjor të agjencisë

**URDHËR****Nr. 424, datë 16.10.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE
PËRMBAJTJES SË CERTIFIKATËS SË
CILËSISË PËR PËRPUTHSHMËRINË E
PRODUKTIT BUJQËSOR OSE
USHQIMOR ME SPECIFIKIMET
TEKNIKE TË PRODUKTEVE TË
REGJISTRUARA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 26, të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e formatit dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë, për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara si specialitet tradicional i garantuar (STG), tregues gjeografik i mbrojtur (TGJM) dhe emërtim origjine i mbrojtur EOM”, sipas aneksit 1, bashkëlidhur.

2. Termat (përmbajtja) e përdorur në certifikatën e cilësisë, kanë kuptimin si më poshtë:

- a) emri dhe mbiemri i operatorit të prodhimit;
- b) adresa e operatorit të prodhimit;
- c) emri i produktit bujqësor ose ushqimor;
- ç) kategoria e produktit bujqësor ose ushqimor,

do të jenë të njëjtë me të dhënat e deklaruara nga aplikanti në formatin e aplikimit të produktit bujqësor ose ushqimor;

d) sasia e prodhimit e deklaruar nga operatori ushqimor gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës do të jetë sasia e prodhimit që operatori ka gjendje për treg, në momentin e kryerjes së kontrollit zyrtar;

dh) periudha e vlefshmërisë së certifikatës do të jetë vjetore, bazuar në kontrollet zyrtare sipas analizës së riskut.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**



ANEKS 1



CERTIFIKATË CILËSIE

Konfirmohet përputhshmëria e procesit të prodhimit
të produkteve bujqësore ose ushqimore me specifikimet teknike

Emri dhe Mbiemri i operatorit të prodhimit:	
Adresa operatorit të prodhimit:	
Emri i produktit bujqësor ose ushqimor:	
Kategoria e produktit bujqësor ose ushqimor	
Sasia e prodhimit e deklaruar nga operatori ushqimor gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikates:	
Periudha e vlefshmërisë së certifikates:	

Bazuar në rezultatet e kontrollit të përputhshmërisë së prodhimit të produktit bujqësor ose ushqimor, me specifikimet teknike të përcaktuara në regjistrë, referuar nenit 15, të ligjit nr. 8/2019 datë 26 Shkurt 2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”,

Konfirmohet që:

Produkti _____ është

SPECIALITET TRADICIONAL / TREGUES GJEOGRAFIK / EMËRTIM ORIGJINE
I GARANTUAR I MBROJTUR I MBROJTUR





URDHËR

Nr. 425, datë 16.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË
APLIKIMIT DHE KUNDËRSHTIMIT TË
PRODUKTEVE BUJQËSORE OSE
USHQIMORE SI SPECIALITET
TRADICIONAL I GARANTUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 8, të nenit 19 dhe nenit 8, të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e formatit të aplikimit dhe kundërshtimit, të një produkti bujqësor ose ushqimor si Specialitet Tradicional i Garantuar (STG) për brenda vendit dhe në BE, sipas anekseve përkatëse bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

Aneksi 1



**FORMULAR APLIKIMI
PËR REGJISTRIM TË PRODUKTIT BUJQËSOR OSE USHQIMOR SI
SPECIALITET TRADICIONAL I GARANTUAR
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel.: +355 (0) 422 _____ E-mail: info@bujqesia.gov.al Web: www.bujqesia.gov.al Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN Referenca: Data:
--	--

SEKSIONI I: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

Grupi i Prodhuesve			
1. Emri			
2. Statusi Ligjor			
3. Adresa			
4. Nr. Telefoni			
Person fizik/juridik			
1. Emri		2. Mbiemri	
3. Atësia		4. NID	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
		Nr. identifikimit personal	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
SEKSIONI I.1: INFORMACION SPECIFIK MBI PËRFAQËSUESIN E APLIKANTIT			
1. Emri		2. Mbiemri	
3. Adresa			
4. Nr. Telefoni		5. Email	

**SEKSIONI II: INFORMACION MBI SPECIFIKIMIN E PRODUKTIT**

1. Shënoni më poshtë emrin që do të regjistrohet:

2. Lloji i produktit (sipas urdhrit nr. __, datë __. __. 2020):

3. ARSYET PËR REGJISTRIM

3.1. Nëse produkti:

☐ rezulton nga një mënyrë prodhimi, përpunimi apo përbërje që lidhet me një praktikë tradicionale për atë produkt apo ushqim;

☐ prodhohet nga lëndë e parë apo përbërës që përdoren tradicionalisht.

[Jepni shpjegime]



3.2. Nëse emri:

☐ është përdorur tradicionalisht për t'iu referuar produktit specifik;

☐ identifikon karakterin tradicional ose karakterin specifik të produktit.

[Jepni shpjegime]

**4. PËRSHKRIMI**

4.1. Përshkrimi i produktit

(nënpika ii e pikës 3 (b) e nenit 8 të ligjit 8/2019 datë 26.2.2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”)

4.2. Përshkrimi i metodës së prodhimit

(nënpika iii e pikës 3 (b) e nenit 8 të ligjit 8/2019 datë 26.2.2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”)



4.3. Përshkrimi i vetive kryesore që krijojnë karakterin tradicional të produktit

(nënpika iv e pikës 3 (b) e nenit 8 të ligjit 8/2019 datë 26.2.2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”)

--

SEKSIONI III: INFORMACION MBI PROCEDURËN DHE SHPESHTËSINË E KONTROLLIT PËR PËRPUTHSHMËRINË E PRODUKTIT ME SPECIFIKIMET

--

SEKSIONI IV: PËRMBLEDHJE E SPECIFIKIMEVE TË PRODUKTIT

Përmbledhje e specifikimeve të produktit

(pika 3 (d) e nenit 8 të ligjit 8/2019 datë 26.2.2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”)

--

SEKSIONI V: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Lista e dokumenteve të paraqitura së bashku me aplikimin për regjistrim

--

SEKSIONI VI: PAGESA

Dokument që konfirmon pagesën e tarifës së regjistrimit

1. Tarifë aplikimi për regjistrimin e STG

2. Lloji i pagesës

3. Data

--

--

--	--	--	--	--	--	--	--

(Data)

(Muaji)

(Viti)

4. Llogaria bankare ku do të kryhet pagesa

--



Aneksi 2



FORMULAR APLIKIMI

PËR KUNDËRSHTIM TË REGJISTRIMIT TË PRODUKTIT BUJQËSOR OSE USHQIMOR
SI SPECIALITET TRADICIONAL I GARANTUAR
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel.: +355 (0) 422 _____ E-mail: info@bujqesia.gov.al Web: www.bujqesia.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN Referenca: Data:
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

**SEKSIONI I: INFORMACION SPECIFIK MBI KUNDËRSHTUESIN E
SPECIALITETIT TRADICIONAL TË PUBLIKUAR**

Person fizik	
1. Emri	
3. Atësia	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër
7. Vendlindja	
9. Adresa	
10. Qyteti	
12. Kodi Postar	
14. E-mail	
PERSON JURIDIK/GRUPI I PRODHUESVE	
1. Emri	
3. Adresa	
4. Nr. Telefoni	
2. Mbiemri	
4. NID	
Nr identifikimit personal	
6. Datëlindja	
(Data) (Muaji) (Viti)	
8. Shtetësia	
11. Rrethi	
13. Nr. Tel.	
15. Tel/Fax	
2. NUIS	

SEKSIONI II: EMRI I PRODUKTIT

Shënoni më poshtë emrin si jepet në publikim:

**SEKSIONI III: REFERENCA ZYRTARE**

Të dhëna lidhur me specialitetin tradicional:

1. Numri i kërkesës

2. Data e depozitimit

(Data)	(Muaji)	(Viti)					

3. Numri i publikimit

4. Data e publikimit

(Data)	(Muaji)	(Viti)					

SEKSIONI IV: ARSYET PËR KUNDËRSHTIM
☐ mospërputhshmëri me kushtet e përcaktuara në nenin 6 të ligjit 8/2019, datë 26.02.2019
 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”

☐ Emri i propozuar për regjistrim është i ligjshëm, i njohur dhe ekonomikisht i rëndësishëm
 për produkte të ngjashme bujqësore ose ushqimore
SEKSIONI V: DETAJET E KUNDËRSHTIMIT

Jepni arsye të vërtetuara dhe argumentim të justifikuar për kundërshtimin

Jepni një deklaratë që shpjegon interesin legjitim të kundërshtimit

SEKSIONI VI: PAGESA

Dokument që konfirmon pagesën e tarifës së regjistrimit të aplikimit

1. Tarifë aplikimi për
kundërshtimin e regjistrimit
të STG

2. Lloji i pagesës

3. Data

(Data)	(Muaji)	(Viti)					

4. Llogaria bankare ku do
të kryhet pagesa



SEKSIONI VII: PRANIMI I APLIKIMIT

Shënim: Është përgjegjësi e nënshkruesit të kërkesës çdo mospërputhje e të dhënave të formularit me dosjen e paraqitur

Formular i deklarimit të të dhënave personale

Unë i/e nënshkruari (a) pranoj që MBZHR mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura me procedurat e parashikuara në Ligjin nr. 8/2019, datë 26.02.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

☐ nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën:

☐ nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin:

☐ nëpërmjet fax-it në numrin:

MBZHR njofton se shënim i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. MBZHR do të ruajë këto të dhëna (në vijim të “Dhënat Personale”), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar kanë shënuar në këtë formular.

Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga MBZHR, në cilësinë e Kontrolluesit apo nga persona të tretë të caktuar nga MBZHR, në cilësinë e Përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me aplikantin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t’i kalohen një marrësi të tretë, pa pëlqimin paraprak të aplikantit dhe nuk do t’i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

MBZHR mund të përdorë herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar aplikantin dhe për t’i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së MBZHR. MBZHR do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim MBZHR, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Aplikanti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që MBZHR ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësiave penale që rrjedhin nga deklarimi dhe nga paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që MBZHR të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të aplikantit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

Nënshkrimi i Aplikantit

--	--	--	--	--	--	--	--

(Data)

(Muaji)

(Viti)



Aneksi 3

**REGISTRATION APPLICATION FOR AGRICULTURAL PRODUCT
OR FOODSTUFF AS TRADITIONAL SPECIALTIES GUARANTEED****I. APPLICANT'S DETAILS**

1. NAME:
2. REGISTERED OFFICE, ADDRESS, CONTACT DETAILS:
3. NAME AND SURNAME OF THE PERSON ACTING ON BEHALF OF THE APPLICANT:
4. GROUP:

II. PRODUCT SPECIFICATION

1. NAME(S) TO BE REGISTERED

....

2. TYPE OF PRODUCT [AS IN MINISTER'S ORDER]

....

3. GROUNDS FOR REGISTRATION

- 3.1 Whether the product:

☐ results from a mode of production, processing or composition corresponding to traditional practice for that product or foodstuff

☐ is produced from raw materials or ingredients that are those traditionally used.

[Provide explanation]

☒

- 3.2 Whether the name:

☐ has been traditionally used to refer to the specific product

☐ identifies the traditional character or specific character of the product

[Provide explanation]

☒

4. DESCRIPTION

4.1 Description of the product to which the name under point 1 applies, including its main physical, chemical, microbiological or organoleptic characteristics showing the product's specific character (Article 8 Paragraph 3 b ii of the Law No. 8/2019, dated 26 February 2019, "On Quality Schemes of Agricultural and Food Products")

4.2 Description of the production method of the product to which the name under point 1 applies that the producers must follow including, where appropriate, the nature and characteristics of the raw materials or ingredients used, and the method by which the product is prepared (Article 8 Paragraph 3 b iii of the Law No. 8/2019, dated 26 February 2019, "On Quality Schemes of Agricultural and Food Products")

4.3 Description of the key elements establishing the product's traditional character (Article 8 Paragraph 3 point b iv of the Law No. 8/2019, dated 26 February 2019, "On Quality Schemes of Agricultural and Food Products")

**III. INFORMATION ON THE PROCEDURE AND FREQUENCY OF THE PRODUCT COMPLIANCE CHECK WITH THE SPECIFICATION****IV. SUMMARY OF THE PRODUCT SPECIFICATIONS**

In particular the data as specified in points 3, letter “b”, items i-iv of the article 8 of the Law no. 8/2019, dated 26 February 2019, “On quality schemes of agricultural and food products”

V. THE LIST OF DOCUMENTS SUBMITTED TOGETHER WITH THE APPLICATION FOR REGISTRATION**VI. DOCUMENT CONFIRMING THE PAYMENT OF THE FEE FOR REGISTRATION****STATEMENT OF OPPOSITION FOR TSG APPLICATION****1. NAME OF PRODUCT**

[as given in publication]

“...”

2. OFFICIAL REFERENCE

[as given in publication]

Date of publication: ...

3. CONTACT DETAILS

Contact person: Title (Mr., Ms...): ... Name: ...

Group/organization/individual: ...

Address: ...

Telephone+...

E-mail address:...

4. REASON FOR THE OPPOSITION:

☐ Non-compliance with the conditions laid down in Article 6 of the Law no. 8/2019, dated 26 February 2019, “On quality schemes of agricultural and food products”

☐ The name proposed for registration is lawful, renowned and economically significant for similar agricultural products or foodstuffs

5. DETAIL OF OPPOSITION

Provide duly substantiated reasons and justification for the opposition.

Provide also a statement explaining the legitimate interest of the opposition

The statement of opposition should be signed and dated.

**KËRKESË****Nr. 6395/6, datë 19.10.2020****PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR
SHKËMBIMIN E PRONËS,
PËR INTERES PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasurinë e llojit “tokë arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të

pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në shkresën nr. 6617/1, datë 29.9.2020, të Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 2, të ASHK-së.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Bashkisë Tiranë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 47 368 594 (dyzetë e shtatë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, DHE/OSE SHKËMBEHEN, PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR "ZONË TË RE PËR ZHVILLIM", NJËSIA ADMINISTRATIVE "VAQARR", BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM DHE/ OSE KOMPENSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË										Vlera totale (lekë)	Kompensim në vlerë/shkëmbim	KONFIRMUAR/SHËNIME		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pas.	Lloji II pas.	Sip. truall/arë totale m²	Shpronësim tokë "truall"			Shpronësim tokë "arë"			Sip. ndërtesë totale (m²)	Ndërtesë banimi (shëtipi)							Ndërtesë jo banimi
								Sip. e prekur (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		Sip. e prekur (m²)	Çmimi mes. sh/blejësve sipas ASHK (l/m²)	Vlera (lekë)					
PRONË PRIVATE																						
1		Liera e Bashkëpronarëve Taku		3712	81/10	Truall	7,895.0	3758	528	1,984,224					0		0	1,984,224	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020.	Në përshkrimin e veçantë thuhet: "Dëshmi trashëgimie nr. dok. 1378, nuk është sjellë certifikatë origjinale. Nuk është leshuar certifikatë."	
2	Bedri	Hysen	Taku	3712	81/3	Arë	3,000.0				3,000.0	448	1,344,000.0		0		0	1,344,000	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020.	Në seksionin E ka shënimin: Vendoset maza e sekuestros konservative, nr. dok. 1902, dt. 11.3.2009 dhe nr. 2209, dt. 29.3.2011	
3	Riza/Alin ShpëtimRe shat VllëRrahim e	Qamil Riza	TakuTaku	3712	79/8	Truall+ndërtesë	82	82	528	43,296				82.00	82	82,466	6,762,212	6,805,508	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.9.2020.		
4		Selim Telha Telha	TakuTakuTak uTaku	3712	79/15	Truall	380	380	528	200,640					0		0	200,640	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020.		
5	Riza GentianaAlin	Qamil Riza	TakuTakuTaku	3712	79/6	Truall+ndërtesë	169	169	528	89,232				169.00	169	82,466	13,936,754	14,025,986	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020, si edhe nr. prot. 6617/1, dt. 29.9.2020.		
6	Zera	Sami	Mullaymeri	3712	79/13	Truall+ndërtesë	152.5	152.5	528	80,520				152.5	152.5	82,466	12,576,065	12,656,585	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.9.2020.		
7	Dashurje	Dervish	Mullaymeri	3712	79/10	Truall+ndërtesë	59.7	59.7	528	31,522				59.70	59.70	82,466	4,923,220	4,954,742	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.9.2020.		
8	Lumtur	Baki	Taku	3712	79/11	Truall+ndërtesë	26.5	26.50	528	13,992				26.50	26.50	82,466	2,185,349	2,199,341	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020, si edhe nr. 6617/1, dt. 29.9.2020.		
9	Hamdi	Beqir	Taku	3712	79/2	Truall	1450	1450	528	765,600				0	0	0	0	765,600	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020.		
Kompensimi në vlerë (lekë)								6,077.70	528	3,209,026	3,000.00	448	1,344,000		489.70	82,466	40,383,600	44,936,626				
PA INFORMACION NË ASHK																						
1	Pa informacion	3712	79/18	Truall		4606	528	2,431,968									2,431,968			Shkresa nr. prot. 3134/1, dt. 20.7.2020.		
Kompensimi në vlerë (lekë)									4606	2,431,968							2,431,968					
NË PROCES LEGALIZIMI NË ASHK																						
1	Shpëtim	Bedri	Taku			Objekti nr. 1									139.60			139.6	Përfshim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/8, datë 31.8.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM-së nr. 8, dt. 6.1.2020.	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020.		
2	Dilaver	Bedri	Taku			Objekti nr. 2									64.50			64.5	Përfshim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/9, datë 31.8.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM-së nr. 8, dt. 6.1.2020.	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020.		
3	Vllë	Telha	Taku			objekti nr. 4									132.90			132.90	Përfshim nga legalizimi shkresa nr. prot. 3134/7, datë 31.8.2020, do të trajtohen sipas pikës 10, të VKM-së nr. 8, dt. 31.8.2020.	Shkresa nr. prot. 228/5, dt. 19.2.2020, shkresa nr. prot. 3134/5, dt. 31.8.2020.		

Page | 12699

Shtënimë:

1. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj lësie, janë bazuar në shkresat nr. 228/1 prot., datë 14.1.2020, nr. 228/5 prot., datë 19.2.2020, nr. 3134/1, datë 20.7.2020, nr. prot. 3134/5, datë 31.8.2020, të ASHK-së, Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.
2. Për vlerësimin e pasurive të llojit "truall" i jemi referuar VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016
3. Për vlerësimin e pasurive të llojit "ndërtësia", çmimi i mësht bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpërndohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, si më poshtë vijon:
a) me funksion "banim" është bërë sipas shkresës nr. 6617/1, datë 29.9.2020, të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të ASHK-së.
4. Përjashmja nga legalizimi i objekteve, të vetëdeklaruarra është bërë me shkresat nr. prot. 3134/6, nr. prot. 3134/7, nr. prot. 3134/8 dhe nr. prot. 3134/9, datë 31.8.2020, bashkëlidhura shkresës nr. prot. 3134/5, datë 31.8.2020, të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të ASHK-së

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë